

Mahir DOMI (1915-2000)

29 dhjetor 2007

Përmbledhje

Ishte një ndër themelvënësit e arsimit të lartë dhe të shkencës albanologjike në Shqipëri. Prandaj emri i tij do të zërë një vend nderi në historinë e arsimit dhe të shkencës sonë, krahas emrave të tillë të nderuar si Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipoja, Eqrem Çabej, Aleks Buda, Selman Riza, Shaban Demiraj, Idriz Ajeti etj.

Lindi në Elbasan. Si mbaroi shkollën fillore në qytetin e lindjes, i vazhdoi studimet e mesme më parë në Normalen e Elbasanit dhe më pas në Liceun Francez të Korçës, të cilin e mbaroi me përfundime të shkëlqyera më 1937. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Grenoblit (Francë), ku më 1939 mori diplomën *Licence d'Enseignement* dhe më 1941 diplomën *d'Etudes Superieures* në letërsi. Në vitin 1941 filloi punën në Shkollën Normale të Elbasanit. Qysh nga viti 1947 ka punuar vazhdimisht në Tiranë, më parë në ish - Institutin e Shkencave dhe në ish - Institutin e Lartë Pedagogjik dhe më pas në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë. Ishte ndër anëtarët e parë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Mahir Domi ishte prototipi i shkencëtarit dhe pedagogut të palodhur, që të gjitha dijet e tij i vuri në shërbim të shoqërisë shqiptare në një nga periudhat më të vështira dhe më dinamike të zhvillimit të saj. Në një kohë kur zhvillimi i arsimit të të gjitha niveleve dhe i shkencave albanologjike në veçanti në Shqipëri aq shumë kishte nevojë për njerëz të ditur e të përkushtuar, Mahir Domi ishte ndër të parët që iu përvesh punës, duke vënë në shërbim të atij zhvillimi të gjithë kulturën e shumanshme dhe përvojën e tij të çmuar.

I tërë personaliteti i tij mund të përmblihet në tri fusha kryesore: **si organizues i mirë, si shkencëtar dhe si pedagog.**

Për çështjen e parë nuk është fjala vetëm për përgjegjësitë që ai nuk ngurroi asnjëherë t' i merrte përsipër për të drejtuar Katedrën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, kur u themelua Universiteti i Tiranës më 1957, si dhe Sektorin e gramatikës e të dialektologjisë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, por edhe organizimin e punës për sendërtimin e një vargu projektesh kërkimore. Gjatë kësaj kohe ai mori një varg nismash si:

Duke qenë i vetëdijshëm se për një studim shkencor të thelluar të gjuhës shqipe ishte e nevojshme të bëheshin hulumtime të shumanshme, ai mori masat e duhura për krijimin e një kartoteke të gramatikës dhe për studimin e dialekteve dhe të folmeve të ndryshme

të shqipes. Si rrjedhim, u krijua një kartotekë e pasur, që shërbeu shumë për hartimin e gramatikës shkencore të gjuhës shqipe, vëllimi i parë i së cilës, morfologjia, u botua si libër më 1976 dhe u ribotua më 1995, ndërsa pjesa e dytë, sintaksa, u botua si libër më 1997. Njëkohësisht u ndërmorën një varg ekspeditash dialektologjike që bënë të mundur hartimin e një vargu monografish dialektologjike si dhe botimin e serisë *Dialektologjia shqiptare*, u përgatit gjithashtu edhe *Atlasi dialektor i gjuhës shqipe*, që është në shtyp.

Nën drejtimin e prof. Domit në Sektorin e gramatikës pranë Institutit të Gjuhësisë organizoheshin herë pas here edhe disa debate shkencore për çështje të ndryshme gjuhësore: Ato debate shkencore, në të cilat Mahir Domi me urtinë e tij karakteristike luante edhe rolin e moderuesit ndaj diskutimeve ndonjëherë shumë të zjarrta, qenë një shtysë e fuqishme për rrahjen e mendimeve të ndryshme dhe shpesh të kundërta, pra edhe për gjallërimin dhe zhvillimin e mendimit shkencor.

Por roli i prof. Mahir Domit në organizimin e punës shkencore nuk u kufizua brenda sektorit që ai drejtohte, sepse kishte përmasa më të gjëra. Kështu p. sh. nuk mund të mendohet organizimi i shumë konferencave shkencore, sidomos i Kongresit të drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, pa ndihmesën e çmuar të prof. Mahir Domit. Gjithashtu do pasur parasysh edhe puna e tij e madhe për mbarëvajtjen e revistave shkencore **Buletin shkencor i Institutit të Shkencave** (1946 - 1957), **Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës** (1958 - 1963), **Studime filologjike** (1964), **Gjuha jonë** (1981), **Studia albanica** (1964).

Një fushë tjetër e rëndësishme, ku prof. Mahir Domi ka dhënë një ndihmesë të madhe, ka qenë puna pedagogjike në Institutin e Lartë Pedagogjik dhe në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë të UT-së. Falë përgatitjes së tij të gjerë shkencore dhe ndërgjegjshmërisë së lartë ai ishte treguar i gatshëm të zhvillojë me sukses lëndë të ndryshme të rëndësishme, nga të cilat vlen të veçohen, sidomos kurset e gramatikës historike, të sintaksës dhe të historisë së albanologjisë. Ai ka mbajtur ligjërata shumë të mirëpritura edhe në Universitetet e Prishtinës, të Shkupit etj.

Gjithsesi, për fat të mirë, trashëgimia shkencore që na ka lënë akademiku Mahir Domi është mjaft e gjerë dhe e shumanshme: madje, në më shumë se një fushë ai ka bërë punë prej pionieri. Kemi parasysh sidomos veprën e tij **Morfologjia historike e gjuhës shqipe**, e cila u botua më 1961 nga UT-ja. Kjo vepër e hartuar si tekst mësimor, shënoi një hap të madh përpara në këtë fushë studimesh. Më shumë interes janë edhe artikujt e botuar prej tij mbi lidhjet gjuhësore ilire - shqiptare.

Një fushë tjetër e rëndësishme, ku prof. Mahir Domi ka dhënë një ndihmesë të çmuar, është ajo e sintaksës së gjuhës shqipe. Këtu nuk është fjala vetëm për projektin dhe organizimin e punës për vëllimin II (Sintaksa) të **Gramatikës së gjuhës shqipe**, të botuar nga ASH-ja më 1997, por edhe hartimin e nëntë kapitujve të rëndësishëm të këtij vëllimi, si dhe artikujt të ndryshëm për probleme të sintaksës.

Një ndihmesë të çmuar ka dhënë prof. Mahir Domi (në bashkëpunim me autorë të tjerë) edhe në hartimin e e disa veprave të rëndësishme leksikografike, si: **Fjalori i gjuhës shqipe** i vitit 1954, **Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe** (1976), **Fjalor enciklopedik shqiptar** (1985) dhe një varg fjalorësh terminologjikë shkencash të ndryshme.

Prof. Domi ka botuar edhe një numër të madh artikujsh me vlerë nëpër revista shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ai ka mbajtur kumtesa edhe në shumë konferenca

dhe kongrese ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe disa nga kongreset e organizuara nga AIESEE.

Ka qenë recenzentë i një numri të madh veprash (rreth 16 të tilla).

Ka dhënë një kontributë të madh edhe në fushën e letërsisë, meqë ishte njohës shumë i mirë i saj, sidomos i periudhës së vjetër. Ai ishte edhe një nga bashkautorët e vëllimit I të veprës kolektive **Historia e letërsisë shqipe**, botuar po ashtu nga ASHSH - ja në vitin 1983 dhe ribotuar në Prishtinë më 1989.

Marrë nga libri **Gjuha shqipe, Probleme dhe disa figura të shquara të saj**, të **Shaban DEMIRAJT**, botuar në Tiranë më 2003

E përgatiti: **Agim SPAHIU**